



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 37  
Prishtinë, 08 prill 2009, ora 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Nurishahe Hulaj dhe Qamile Morina.

Munguan: Bujar Bukoshi, Flora Brovina dhe Slllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Ministria e Shëndetësisë z. Alush Gashi- ministër, Flakëron Sylejmani, Arsim Qavderbasha , Skënder Berisha , Arianit Jakupi dhe Arbër Rogova.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Alush Gashi;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

## 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Alush Gashi

**Sadik Idriz** - Tha se Komisioni në bazë të planit të punës e ka ftuar në takim ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë. Në ftesë janë caktuar pikat, për të cilat Komisioni është i interesuar të diskutojë me ministrin: Informatë rreth gjendjes në shëndetësi; Ku ndodhet në procedurë Ligji për sigurime shëndetësore; Cilat nga prioritetet e përcaktuara nga MSh-së për vitin 2008 janë realizuar dhe cilat janë prioritetet e MSh-së për vitin 2009. Deputetët anëtarë të Komisionit mund të kenë pyetje shtesë. Hapi diskutimin.

**Alush Gashi – ministër në Ministrinë e Shëndetësisë** - Tha se Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale është një mbështetje e madhe për MSh. Shëndetësia në Kosovë ka qenë në një udhëheqje të përzier dhe shpeshherë të çuditshme nën udhëheqjen e UNMIK-ut. Pavarësia apo kalimi i kompetencave në MSh është bërë vetëm pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor ka qenë ndalja e degradimit në MSh dhe këtë ndalje mund ta bëjmë duke respektuar ligjin, me një punë transparente, me një llogaridhënie para Kuvendit, Qeverisë dhe para qytetarëve të Kosovës. Qëllimi ka qenë kthimi i dinjitetit të profesionit si dhe sigurimi i shërbimeve më cilësore për qytetarin, duke respektuar ligjin dhe kushtetutën qasja e barabartë për të gjithë shtetasit e Kosovës, në një vend ku për shëndetësisë në ditë ipen 12 cent për qytetar, për një muaj për një qytetar kemi 3.60cent, për 360 ditë kemi 45 euro për qytetar. Për një vit është arritur që për disa herë të rritet buxheti për farmaci. Me fillim të mandatit ky buxhet ka qenë **8.8** milion euro duke përfshirë edhe dializën e cila i merr duku afër 4 milion. Kemi arritur që buxhetin ta rrisim në 16 milion e 100 mijë. Që nga viti 2003 shumë pacient kanë qenë në pritje për trajtim jashtë vendit për shërbime të cilat nuk ekzistojnë në republikën tonë. E kemi trashëguar një linjë buxhetore për këtë e që ishte 500 mijë euro dhe ne kemi arritur që kjo të rritet për 4 herë.

Në vitin 2008 i kemi realizuar të gjitha investimet kapitale, kemi realizuar buxhetin e farmacisë dhe kemi realizuar numrin më të madh të inspektimeve, me një numër shume modest të inspektorëve. Numri më i vogël i inspektorëve që nevojiten për republikën tonë është 12 dhe kemi angazhim maksimal që ai numër i inspektorëve të rritet. Rritje a numrit të punësuarve në sektorin publik është shumë e vështirë dhe gati e pamundur.

Jemi në një situatë të vështirë ku mortaliteti është më i larti në kontinent. Ka specialistë pa punë. Zgjidhja e vetme është që sektori shëndetësor të trajtohet si kategori e veçantë, pra të hiqet nga sektori i shërbyesve civil, në mënyrë që të kemi mundësi për punësimin e profesionistëve.

Rreth 50% e popullatës sonë nuk kanë ujë të pijshëm, çka do të thotë se mbi 50% e qytetarëve tanë në vazhdimësi pijnë ujë me baktere. Ne kemi specialistë të ujit të cilët nuk mundemi t'i punësojmë. Përgëzoi komisionin që ka bërë monitorimin e ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi. Monitorimi ka filluar në kohën e dinamizimit të MSh-së dhe shumica e vërejtjeve me vend të cilat i ka bërë grupi punues, fatmirësisht janë zgjidhur sot. Sot mund të ju raportoi se nga 31 janari nuk pritet më shumë se si është e paraparë me ligj për vlerësim të një aplikimi për një institucion privat shëndetësor. Me hyrjen në fuqi të ligjit për menaxhim të financave publike, ne nuk mundemi të paguaj njerëzit brenda orarit të punë as jashtë orarit të punës.

Reformat në shëndetësi nuk janë të lehta, janë të dhimbshme, kërkojnë mbështetje buxhetore dhe mbi të gjitha kërkojnë një konsensus nacional.

Në bazë të ligjeve në fuqi jemi të obliguar të përgatisim një *master plan* nacional. Ne jemi duke e përgatitur që ta procedojmë në Kuvend. *Master plani* për tu zbatuar nuk është çështje e një mandati qeveritar. Ky *master plan* ka një kosto të lartë buxhetore, prandaj na duhet një konsensus nacional.

Ne kemi iniciuar procedurat për plotësim ndryshim të ligjeve si: Projektligji për plotësim ndryshim të ligjit për duhanin, projektligji për plotësim ndryshim të ligjit për produkte medicinale, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për shëndetësi, Projektligjin për sigurime shëndetësore, Projektligjin për plotësim ndryshim të ligjit për veprimtari private në shëndetësi, Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës, projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq të Kosovës.

Po ashtu në kuadër të reformave jemi duke punuar intenzivisht rreth ripunimit të udhëzimeve administrative.

Na nevojitet informacion lidhur me sigurimet shëndetësore - a do të kemi një fazë tranzitore lidhur me një ngritje të buxhetit deri në themelimin e fondit, apo do të ketë mundësi që menjëherë të fillohet me fondin për sigurime shëndetësore.

Sa i përket raportit në mes të shëndetësisë private dhe asaj publike ne kemi shumë modele. Grupi punues po merret me këtë çështje. Në këtë grup punues janë të përfshirë ekspert nga MSh, praksa private, shoqëria civile dhe tryeza është e hapur për të gjithë ata që mund të kontribuojnë.

**Rita Hajzeraj** – Tha se me vëmendje e përcjell gjendjen në shëndetësi dhe se nuk është e kënaqur me buxhetin që vazhdimisht i ndahet kësaj ministrie, e që nuk është i kënaqshëm. Kjo është një e metë e secilës qeveri që po vije në pushtet, pasi që shëndetësia nuk po konsiderohet prioritet. Deri ku ka arritur MSh-ja në përgatitjen e Ligjit por sigurime shëndetësore, duke e ditur që ky ligj është bazik për shëndetësinë? Për shkak të restriksioneve shumë specialist nuk mund të punësohen. Pyeti: cilat janë këto restriksione që po pengojnë punësimin e specialistëve dhe a ka ndonjë alternativë MSh për të punësuar këta specialist.

**Alush Gashi** – Tha se buxheti i tanishëm është 15 % me i lartë krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Ne kemi kërkuar buxhet shtesë dhe këtë e kemi kërkuar në MEF –i që të shikohet mundësia që nga të hyrat doganore të produkteve si karburant, duhan, alkool si dhe produkteve të luksit 10 % të shkojnë drejtë për MSh-në. Këto janë produkte që drejtpërdrejt bëjnë dëm në shëndetin e qytetarëve.

Lidhur me Ligjin për sigurime shëndetësore, ai tha se ky ligj është miratuar në Kuvendin e Kosovës, por nuk është nënshkruar nga PSSP-ja. Grupi punues është duke punuar. Propozimi ynë aktual është që 10% e buxhetit të ndahet për shëndetësinë për 3-5 vitet e ardhshme. Gjatë kësaj kohe të filloi pagesa e kontributeve në Fondin për shëndetësi. Kemi disa analiza të ekspertëve për përqindjen e atij kontributi. Problemi qëndron se numri i të punësuarve është i vogël dhe si do të veprohet nëse është një i punësuar dhe nga ky i punësuar marrim 2% nga të ardhurat dhe 2% nga punëdhënësi i tij, tani ky sigurim a përfshin të gjithë anëtarët e familjes apo jo. Ky studim ka marrë për bazë një faktor 3.2 dhe nëse fillohet me nivelin më të ulët të kontributeve atëherë do të kemi dyfishi të buxhetit. Ne do të shikojmë mundësitë praktike. Duhet ta kemi parasysh se kur flasim për buxhetin e shëndetësisë, flasim për nivelin sekondar dhe terciar. Gjatë gjithë këtij procesi ne duhet të kemi parasysh dhe duhet të kemi *master planin* së paku për 10 vitet e ardhshme. Në kuadër të kësaj, është puna e revidimit të strategjive sektoriale. Janë formuar të gjitha grupet për revidimin e strategjive. Për punësimin e ekspertëve ne vitin e kaluar kemi arritur që të fitojmë mbështetjen e të gjithëve, që të lejohet rritja për 91 specialist që ishit të papunë në listë, dhe në ditën e shpalljes ai numër u bë 200. Ne nuk mundemi të hapim shumë qendra të shëndetit mendor sepse nuk lejohet rritja e numrit të të punësuarve. Aktualisht jemi në fazën përfundimtare të rehabilitimit të hapësirës për kardiokirurgji, por për kardiokirurgji ne na nevojitet lejimi i vendeve të reja të punës.

**Sadik Idriz- Pyeti:** A do ta kemi draftin e Ligjit për sigurime shëndetësore në qershor.

**Alush Gashi** – Tha se Projektligji për sigurime shëndetësore do të procedohet para pushimeve verore dhe draftin e tanishëm në mund të sjellim komisionit para se ta procedojmë në Qeveri.

**Gjynaze Syla** – Pyeti: Nëse Ligji për sigurime shëndetësore është paraparë të procedohet në qershor të këtij viti, domethënë që MSH e ka zgjidhur problemin e Fondit. Cila është kjo zgjidhje dhe sa është kostoja totale e këtij Projektligji.

Sa i përket statusi të punëtorëve shëndetësor, ne kemi pasur Ligjin e punës dhe nga ajo ne nuk kemi parë që Qeveria ka një politikë të qartë rreth të punësuarve, e aq më pak rreth ndarjes së kësaj kategorie nga kategoria e shërbyesve civil. Sa ka arritur MSH-ja në këtë aspekt. Cila është reforma që do të zbatoni brenda MSh-së, duke ditur se ka shumë të punësuar në administratën e MSh e pastaj nuk ka profesionist

Cilat investime kapitale janë paraparë për vitin 2009? A ka suficit MSh-ja për vitin 2008, nëse ka sa është vlera e këtij suficiti? Sa i përket *master planit* a ka ndonjë vlerësim se sa do të jetë kostoja e këtij *master plani*?

**Alush Gashi** - Tha se P/Ligji për shërbyesit civil do të vjen në Kuvend së shpejti dhe në atë projektligj në nenin 3 thuhet se punëtorët shëndetësorë nuk do të jen shërbyes civil. Kjo na hap mundësi krejt tjera.

Sa i përket pyetjes për P/Ligjin për sigurime shëndetësore, grupi punues propozimin aktual e ka që për tri deri në pesë vite të krijohet fondit. Kemi propozuar që si fillim të 10% e buxhetit të Kosovës të jetë për shëndetësi . Të fillohet me mbledhje të kontributeve nga individët dhe të fillon formimi i fondit.

**Arsim Qavderbasha** - Tha se sipas parashikimeve që kemi bërë me një numër të punësuarve prej 268 mijë sa llogaritet që janë në Kosovë , arrijmë me i mbuluar rreth 857 mijë e 600 anëtar të familjeve . Kështu do të arrijmë deri te një shumë e fondit prej 44 milion e 500 mijë euro, ku 71 % vijnë nga sektori privat. Kjo llogaritje vjen nga një kontribut prej 5% te rrogës bazë , ku 2.5 % nga punëtori dhe 2.5% nga punëdhënësi. Rreth 1 milion e 342 mijë banor mbesin që nuk kontribuojnë dhe kostoja për personat që nuk punojnë është rreth 81 milion euro. Këtë shumë mendojmë ta krijojmë duke derdhur mjete nga buxheti i shtetit. Ky është një nga skenarët e mundshëm.

**Mimoza Ahmetaj** - Pyeti : Për sa vite mund të filloj të shfrytëzohet fondit?

**Arsim Qavderbasha** – Nëse do fillon krijimi i fondit nga viti i ardhshëm , mund të filloj të shfrytëzohet për 3 deri në 5 vjet.

**Alush Gashi** - Tha se lidhur me P/Ligjin për sigurime shëndetësore kemi tri variante dhe kemi analizuar edhe ngarkesën që thuhet që vjen nga pushimi i lehonisë . Sipas analizave që kemi bërë numri i shtatzënisë së të punësuarave nuk është i madh, prandaj pjesa më e rëndësishme e Ligjit është mbrojtja e të punësuarave që janë shtatzëna.

Regjistrin e investimeve kapitale jua kam përcjell në mënyrë elektronike.

**Qamile Morina** - Tha se shëndetësia është në një gjendje të rëndë dhe duhet ti qasemi në një formë shumë serioze. Ne i kemi indikatorët më të lart të shëndetësisë në Evropë si vdekshmëria e foshnjave , jetë gjatësia , rritja e sëmundjeve ngjitëse etj. Këto qëllime nuk po përmbushen nga sistemi jonë shëndetësor . Pacientët ton nuk janë të mbrojtur nga risku financiar sepse pacientët ton shumë blejnë barna dhe dërgohen për shërim jashtë vendit, që do të thotë nuk janë të mbrojtur.

Cilët janë hapat që i paraprijnë qëllimeve të reformës që po e synoni në shëndetësi?

Ju keni një strategji legjislativë deri në vitin 2015 a keni arritur të nxjerrni planin e veprimit për këtë periudhë? A mendoni që keni kapacitete institucionale për realizimin e reformave në shëndetësi ?

Ju patjetër duhet ta bëni një organogram të ri për realizimin e reformës në shëndetësi. Sa po mendoni ta bëni edhe redistribuimin e personelit në vendet rurale ?

**Mimoza Ahmetaj** - Pyeti lidhur me ndërtimin e spitalit të Prishtinës, i ndarë nga QKU , ku keni arritur me planin e ndërtimit të këtij spitali?

Si e mendoni ju si ministër çështjen e shëndetësisë private dhe asaj publike , e shihni si të ndarë , si të kombinuar apo kështu si është?

**Nurisha Hula** - Pyeti : Ku ka ngelur procedura me 44 eurot e premtuara për punëtorët shëndetësor ? Gjithashtu pyeti se në master planin e shëndetësisë a janë përfshira sëmundjet kronike jo infektuese të cilat janë shumë të përhapura në Kosovë ? A ka mundësi të hyrat vetanake shëndetësore të decentralizohen dhe se ku ka arritur procedura e nënshkrimit të memorandumit me MEF për shfrytëzimin e të hyrave vetanake të sektorit shëndetësor.

**Teuta Hadri** - Pyeti për çështjen e rimbursimit të 20% , a është realizuar ende , ku qëndron procedura ?

**Armend Zemaj** – Pyeti për sistemin informativ shëndetësor sa është duke u punuar në këtë drejtim?

**Alush Gashi** - Tha se ky takim është një mbështetje për punën e Ministrisë së Shëndetësisë.

Sa i përket pyetjes së vdekshmërisë së foshnjave, ka një rënie prej 30% , por ende është e lart. Së shpejti do të fillojmë edhe me projektin e neonatologjisë. Do ta kemi një qendër kombëtare të neonatologjisë. Organogrami aktual duhet patjetër të ndryshohet por kjo mundësi ende nuk ekziston deri në nxjerrjen e punëtorëve shëndetësorë nga shërbyesit civil.

Listën e produkteve medicinale dhe barna si dhe për investime kapitale e kanë bërë vet ekspertët e asaj lomie. Si ministër, drejtorin e QKUK- së nuk kam mandat ta ndërroj. Kemi probleme edhe me procedurat e KRPP - së.

Të hyrat vetanake derdhen në buxhetin e Kosovës dhe buxheti ndahet një herë në vit. Ne kemi propozuar që kujdestarit të hyn në buxhet dhe 44 eurot të hyn në vij buxhetore paga dhe medita dhe mos ta kemi këtë problem . Ky propozim është dorëzuar në Qeveri më 1 prill dhe presim që do të ketë mbështetje.

Lidhur me pyetjen për planin e punës ne kemi planin mujor të punës si dhe planin njëvjeçar si dhe i bëjmë raport tremujor Qeveris për punën tonë.

Për sistemin informativ shëndetësor, kemi formuar grupin për revidimin e planit të sistemit informativ shëndetësor.

**Gjylanze Sylja** - Pyeti : Si mund të kemi sistem informativ shëndetësor kur nuk e kemi popullsinë e regjistruar.

**Alush Gashi** - Tha se mos regjistrimi i popullsisë është një problem evident. Ndërsa sa i përket rimbursimit është duke u punuar por kjo është një punë mekanike që donë kohë. Në kornizën afatmesme të shpenzimeve ne e kemi parapa ndërtimin e spitalit të Prishtinës me kapacitet të punësuarve prej 500 personave. Kemi shumë projekte të cilat kërkojnë përkrahje dhe bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar është esencjal.

**Sadik Idriz** - Falënderoj ministrin për raportimin para Komisionit.

## **Të ndryshme**

**Gjylnaze Syla** - Propozoj që gjatë mbledhjeve të ketë një punë më racionale dhe mos të bëhet ndërhyrje në diskutimet e njëri tjetrit.

**Sadik Idriz** - Tha se do mundohemi të ketë sa më shumë kolegjalitet në punën tonë dhe të mos ketë asnjë pengesë të qëllimshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 45.

E përgatiti:

*Njësia për Mbështetjen e Komisionit.*

Kryetar i Komisionit

---

Sadik Idriz